

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË
“CAPITAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK**

THEMELIMI

**Neni 1
Ortakët themelues**

- .1 Shoqëria “CAPITAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK themelohet nga Ortakët si më poshtë vijojnë:
- **Ardi BEZO**, atësia Ylber, amësia Nadire, shtetas Shqiptar, lindur në Gramsh dhe banues në TIRANË, me adresë Rrg. Dritan Hoxha, Tiranë, lindur më 31/10/1983, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I Leternjoftim ID me numër 033819377 dhe nr. personal I31030046J.
 - **Hermes QORRI**, atësia Besim, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Havalehas, dhe banues në TIRANË, me adresë Rrg. Sulejman Delvina; Tiranë, lindur më 20/09/1994, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I Leternjoftim ID me numër. 038296008 dhe nr. personal J40920077P.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

**Neni 2
Emërtimi**


- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është “CAPITAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK.

**Neni 3
Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4
Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.



Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të pacaktuar.

Neni 6
Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rrg. "Lord Bajron"; Godina Nr. 1; Kati Nr. 1; Pasuria Nr. 8/170+3-21; Zonë Kadastrale 8310; Tiranë.
- 6.2 Administratori i shoqërisë mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të rregjistrojë ato ekzistuese sipas ligjeve në fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Administratorit të shoqërisë.

Neni 7
Objekti

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është "Veprimtari në fushën e ndërtimit dhe menaxhimit të pronave të paluajtshme, përfshirë ndërtimin, zhvillimin, dhe shitjen e projekteve rezidenciale dhe komerciale, restaurimin e objekteve publike dhe private, si dhe ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në blerjen, shitjen dhe dhënie me qira të pronave."
- 7.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 8
Kapitali

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmije) Leke.
- 8.2 Kapitali ndahet në 100 (njëqind) pjesë.
- 8.3 Pronësia e kuotave ndahet midis ortakëve si vijon:
- **Z. Ardi BEZO**, zotëron 50 kuota ose 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit e barabartë me një vlerë të përgjithshme prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.
 - **Z. Hermes QORRI**, zotëron 50 kuota ose 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit e barabartë me një vlerë të përgjithshme prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.
- 8.4 Kapitali është shlyer tërësisht.



Neni 9

Transferimi i kuotave. Kufizimet.

- 9.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.
- 9.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10

Rritja e kapitalit

- 10.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 10.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 11

Zvogëlimi i kapitalit

- 11.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 11.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Përgjithshme. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblesë së Përgjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 11.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 12

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Asambleja e Përgjithshme.
- 12.2 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme përfshijnë kryesisht:
 - Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
 - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
 - Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;

- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera.

Neni 13 Administrimi

- 13.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 13.2 Administratorët kanë të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojnë punën e përditshme të shoqërisë veç e veç ose bashkërisht në përputhje me udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 13.3 Administratori i shoqërisë është:
- **Z. Ardi Bezo**, atësia Ylber, amësia Nadire, shtetas Shqiptar, lindur në Gramsh dhe banues në TIRANË, me adresë Rrg. Dritan Hoxha, Tiranë, lindur më 31/10/1983, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I Leternjoftim ID me nr. 033819377 dhe nr. personal I31030046J.
- 13.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
 - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
 - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloji natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;
 - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucione apo entitete publike ose private;
 - Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
 - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;
 - Të vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;
 - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;

- Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për biznesin e shoqërisë në Shqipëri.

13.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 3 (tre) vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14

Viti financiar

- 14.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 14.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 15

Bilanci. Kontabiliteti.

- 15.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asamblesë së Përgjithshme dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 15.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 15.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 16

Te Ardhurat. Dividendi

- 16.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 16.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

- 16.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortakët do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 17

Likuidimi

- 17.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- 17.2 Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 17.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Përgjithshme do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 18

Mosmarrëveshjet

- 18.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 19

Klauzolë mbyllëse


- 19.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, datë 25/09/2024

“CAPITAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK

Ortakët e shoqërisë:

Z. Ardi BEZO

Ardi Bezo


Z. Hermes QORRI

Hermes Qorri
